



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:021897
Datë: 29.04.2024
Numri i dokumentit: 05631084

Ac.nr.7048/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Nora Bllaca Dula, kryetare e kolegjit, Halide Reka dhe Ylber Shurdhiqi, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit N.F nga fshati B....., Komuna e D....., të cilin me autorizim e përfaqëson avokati N.K nga Prizrenit, kundër të paditurës Komuna e Dragashit, për shkak të kompensimit të dëmit, duke vendosur sipas ankesës së paditësit, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren-Dega në Dragash, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.20/2020 i datës 15.12.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 25.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e paditësit N.F nga fshati B....., Komuna e D..... ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren/Dega në Dragash, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.20/2020 i datës 15.12.2020, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar, C.nr.20/2020 i datës 15.12.2020, ka vendosur si në vijim: *“I. Refuzohet kërkesëpadia e paditësit N.F nga fsh. B....., Komuna e D....., përmes të cilës ka kërkuar që të obligohet e paditura Komuna e Dragashit, që paditësit t`i kompensoj dëmin material në shumën prej 4.359 euro, si tërësisht e pabazuar. II Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale”.*

Kundër këtij aktgjykimi paditësi, përmes të autorizuarit të tij, në afat ligjor ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar

dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e paditësit dhe kërkesëpadia e paditësit, gjegjësisht të prishet aktgjykimi i atakuar dhe lënda të kthehet në shkallën e parë në rigjykim.

E paditura nuk ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit e Kosovës pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e paditësit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, me datë 21.09.2018, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi, kundër të paditurës, përmes të cilës ka kërkuar që të detyrohet e paditura që në emër të dëmit material t'ia kompensojë shumën 4.359 Euro. Në padi ka theksuar se në muajt e parë të vitit 2018, fshati B..... është përfshirë nga moti i ligë, ku ka pasur të reshura shiu të intensitetit të lartë, të cilat i kanë dëmtuar shtëpinë dhe për këtë arsye iu është drejtuar organeve kompetente të Komunës së Dragashit, duke kërkuar ndihmë materiale për sanimin e këtij dëmi, ku Komisioni Vlerësues i Komunës së Dragashit, me vendimin 154 të dt. 15.05.2018, ka vendosur që ta ndihmojë paditësin në shumë prej 300 Euro, por pasi që paditësi i ka konsideruar të pamjaftueshme për sanimin e dëmit, atëherë iu është drejtuar gjykatës me padi.

Gjykata e shkallës së parë fillimisht me aktvendimin e C.nr.88/2018 të dt. 01.11.2019, është shpallur jokompetente në pikëpamje lëndore për të vendosur sipas padisë së paditësit, në këtë çështje juridike për kompensim dëmi dhe me të njëjtin vendim e ka hedhur poshtë si të palejuar padinë e paditësit për kompensim dëmi, e më decidivisht si në aktvendimin e ankimuar.

Kundër këtij aktvendimi paditësi përmes të autorizuarit të tij ka ushtruar ankesë duke e atakuar vendimin e shkallës së parë me arsye sikurse në ankesë.

Gjykata e Apelit e Kosovës, pas shqyrtimit të ankesës, me aktvendimin Ac.nr. 34/20 të dt. 21.01.2020, e ka aprovuar ankesën e paditësit dhe e ka prishur aktvendimin C.nr.88/2018 të dt. 01.11.2019, duke e kthyer çështjen në rigjykim dhe vendosje të sërishme.

Gjykata e shkallës së parë, në rigjykim, duke vepruar sipas padisë së paditësit, vërejtjeve të Gjykatës së Apelit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse, si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.20/2020 i datës 15.12.2020, me të cilin e ka refuzuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimin të atakuar, gjykata e shkallës së parë me administrimin dhe vlerësimin e të gjitha provave të palëve ndërgjyqëse, që gjenden në shkresat e lëndës, e ka vërtetuar gjendjen faktike, ku ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pathemeltë, për arsye se nga procesverbali mbi inspektimin në vendin e ngjarjes nga Komuna e Dragashit, nr....., dt. 21.03.2018, u vërtetua fakti se Komuna e Dragashit-Komisioni Komunal për vlerësimin e dëmeve ka konstatuar se dëme nga të reshurat atmosferikë në shtëpinë e paditësit janë në vlerë prej 4.359 Euro, gjë që ka rezultuar edhe nga fotografitë nga vendi i ngjarjes. Nga aktvendimi nr. 154, të

dt.15.05.2018, u vërtetua se Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale e ka aprovuar kërkesën e këtu paditësit për ndihmë në shumë prej 300 Euro. Në bazë të këtyre provave të administruara nuk është vërtetuar se e paditura është përgjegjëse ndaj paditësit, konform nenit 136 par. 1 të LMD-së, ngase me asnjë provë nuk është provuar se e paditura ka detyrim ndaj paditësit, sepse e njëjta nuk i ka shkaktuar dëm material dhe se dëmet kanë ardhur si pasojë e të rreshurave atmosferike. Poashtu sipas vendimit të dt. 16.04.2018 të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale-Divizioni i Ndhimave Sociale-Komisioni Vlerësues, e njëjta e ka aprovuar kërkesën e paditësit për ndihmë në shumë prej 300 Euro, ngase të njëjtat vërtetojnë se këtu e paditura nuk ka detyrime ndaj paditësit. Gjykata i ka vlerësuar edhe pretendimet e paditësit, por që të njëjtat ishin në kundërshtim me provat e administruara.

Andaj, gjykata e shkallës së parë, në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike e refuzoi kërkesëpadinë e paditësit, konform nenit 136 par.1 të LMD-së, ndërsa për shpenzimet e procedurës ka vendosur në bazë të nenit 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g),(j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare, në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së. Gjendja faktike del të jetë vërtetuar plotësisht dhe në mënyrë të drejtë, ku edhe janë dhënë arsye të mjaftueshme rreth mënyrës se vendosjes të cilat i pranon si të rregullta edhe kjo gjykatë. Aktgjykimi i ankimuar po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk qëndron pretendimi ankimor se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par. 2 pika n) dhe përmban mangësi për shkak të cilave nuk mund të shqyrtohet. Aktgjykimi nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet dhe në lidhshmëri me këtë dispozitiv i aktgjykimit është i qartë dhe i përmbarueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për të gjitha faktet vendimtare, të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë, e sipas të cilave edhe është vendosur për pathemelësinë e kërkesëpadisë. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre. Gjykata në arsyetim të aktgjykimit të atakuar ka paraqitur arsye të mjaftueshme në lidhje me refuzimin kërkesëpadisë së paditësit, i cili refuzim është në përputhje me provat e administruara që gjenden në shkresat e lëndës.

Pretendimet e ankuesit për konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, nuk qëndrojnë, pasi që nga shkresat e lëndës konstatohet se të gjitha faktet e çështjes janë provuar me prova përkatëse, të cilat janë administruar në një proces të rregullt gjyqësor, ku gjykata e shkallës së parë, në arsyetim të aktgjykimit, ka paraqitur arsye të mjaftueshme në lidhje me refuzimin e kërkesëpadisë. Në rastin konkret Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë e ka vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike, për faktin se paditësi, përmes padisë së ushtruar, ka kërkuar kompensimin e dëmit material, të cilin pretendon se e ka pësuar

muajt e parë të vitit 2018, kur fshati B..... është përfshirë nga moti i ligë, që është përcjellë me të rreshura shiu të intensitetit të lartë, e të cilat ia kanë dëmtuar shtëpinë paditësit dhe për të cilin dëm paditësi kërkon kompensimin real nga e paditura, si shkaktare e dëmit. Në rastin konkret nga provat e administruara nuk është provuar se e paditura me fajin e saj i ka shkaktuar dëm paditësit, por që dëmi i paditësit është shkaktuar nga të rreshurat atmosferike. E paditura me komisionin vlerësues të saj i ka dalë në ndihmë paditësit, me qëllim që të konstatohet dëmi që është shkaktuar si rezultat i të rreshurave atmosferike, në mënyrë që i njëjti të ketë të drejtë të realizojë një ndihmë nga Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale-Divizioni i Ndihmave Sociale, gjë që e njëjta ia ka ndarë shumën për ndihmë në lartësi prej 300 Euro. Në bazë të nenit 7.1 të LPK-së, parashihet se: *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*, si dhe sipas nenit 319.1 të LPK-së parashihet se: *“Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provoj faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta”*, e që në rastin konkret paditësi nuk ka arritur të provojë se e paditura është përgjegjëse për shkaktimin e dëmit në shtëpinë e tij, kompensimin nga e cila e kërkon, nga çka rezulton se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike.

Gjykata e Apelit vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditësit për zbatim të gabuar të së drejtës materiale, ngase gjykata e shkallës së parë drejtë e ka zbatuar të drejtën materiale kur ka cekur se sipas nenit 136.1 të LMD-së, parashihet se: *“Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”*, e që në rastin konkret e paditura nuk ka kurrfarë detyrimi ndaj paditësit, për shkak se nuk është përgjegjëse ndaj paditësit në bazë të përgjegjësisë në bazë të fajësisë, sepse nuk i ka shkaktuar dëm paditësit, por që dëmi është shkaktuar nga reshjet atmosferike, andaj pretendimet ankimore në këtë drejtim u refuzuan të pathemelta.

Gjykata e Apelit i vlerësoi edhe pretendimet ankimore të paditësit se komisioni i të paditurës për vlerësimin e dëmit ia ka vlerësuar dëmin dhe është konstatuar gjendja e shtëpisë si rezultat i të rreshurave atmosferike, por që në rastin konkret e paditura nuk është përgjegjëse për shkaktimin e dëmit, sepse dëmi në shtëpinë e paditësit është shkaktuar pa fajin e të paditurës, nga të rreshurat atmosferike, andaj pretendimet ankimore në këtë drejtim u refuzuan të pathemelta.

Gjykata e Apelit vlerëson se vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në përputhje me veprimet e ndërmarra procedurale dhe në mbështetje në dispozitën e nenit 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit mori për bazë edhe pretendimet tjera ankimore, por të cilat nuk ishin të themelta dhe të cilat nuk ndikuan që të vendoset ndryshe, prandaj vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 paragrafi 1 pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:021897
Datë: 29.04.2024
Numri i dokumentit: 05631084

Ac.nr.7048/2021, me datë 25.04.2024

Kryetare e kolegjit:
Nora Bllaca-Dula, d.v.